



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 6 shtator 2010, në mbledhjen e pestë të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blekçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj, z. Radisav Peroviq, z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Kap. Hilmi Mehmeti, Komanda Rajonale Kufitare Veriu – Lluzhan, z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë në Podujevë - Njësi për komunitete, z. Mefail Mustafa, OSBE – Zyra regjionale Ekipi për komunitete, z. Adam Walenzik, OSBE, z. Zuzana Kourilova, LMT – KFOR dhe z. Ermira Hatipi KAAD, partnere implementuese UNHCR.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 02.07. 2010

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Miratimi i rekomandimeve në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Kosovës, nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim

Fjalën e hyrjes e paraqiti kryesuesi z. Shaban Ahmeti.

z. Mefail Mustafa, paraqiti sqarime plotësuese dhe njoftoi se në kuadër të kësaj Zyre do të përfshihen edhe dy zyrtarët për kthim të qëndrueshëm të cilët me përvojën e tyre mund të kontribuojnë në mbarëvajtjen e punëve të Zyrës e cila parashihet të themelohet.

Në fund kërkoj që ky Komitet të rekomandoj për numrin e stafit të Zyrës për komunitete dhe kthim dhe atë mbi bazën e Rregullores e cila anëtarëve të këtij Komiteti iu është dërguar së bashku me thirrje dhe material të kësaj mbledhjeje.

z. Burhan Blakçori, e përkrahu këtë iniciativë dhe kërkoi që rekomandimi të nxirret mbi bazën e Rregullores përkatëse.

z. Nebih Behluli, shprehu mendimin se është e nevojshme të merret edhe përvoja e komunave të tjera dhe se kjo çështje do duhej të zgjidhet në mënyrën më të mirë të mundshme.

z. Selver Rama, u interesua të dijë se Kuvendi i Komunës a ka zëvendëskryesues për komunitete.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, parafolësin e njoftoi se Kuvendi i Komunës së Podujevës nuk ka zëvendëskryesues të Kuvendit meqë kjo nuk parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ndërkaq Zyra për të cilën po debatohet është çështje tjetër dhe ka të bëjë me Rregulloren e Qeverisë së Kosovës e cila ju është dërguar me material të mbledhjes.

z. Mefail Mustafa, nënvizoi e theksova pakë më parë se rekomandimi që do t'i dërgohet Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të jetë i qartë për numrin e nëpunësve të Zyrës duke llogaritur edhe dy zyrtarët për kthim të qëndrueshëm.

z. Burhan Blakçori, propozoi që Komitetit për Politikë dhe Financa t'i rekomandohet stafi i Zyrës prej 7 zyrtarëve.

z. Nebih Behluli, u pajtua me propozimin e parafolësit.

z. Millomir Jovanović, theksoi se ky debat ka të bëjë vetëm me miratimin e rekomandimit për numrin e stafit të Zyrës për komunitete dhe kthim dhe shtoi në këtë drejtim deri tash kanë punuar dy zyrtarë për kthim të qëndrueshëm ndërsa tani mbi bazën e Rregullores së cekur kjo veprimtari zgjerohet e me këtë kuptohet rritet edhe numri i zyrtarëve. Duhet ta kemi të qartë se Komiteti për Politikë dhe Financa nuk vendos për rekomandimin, por vetëm e shqyrton, mirëpo kryetari i Komunës me vendim e cakton numrin e stafit të kësaj Zyre.

Gjithashtu duhet ta kemi të qartë se punësimi në këtë Zyrë, ashtu si në gjithë Shërbimin civil, mund të bëhet vetëm përmes konkursit.

Unë konsideroj se stafi prej 5 zyrtarëve është i mjaftueshëm për këtë zyrë, mirëpo sa më shumë zyrtarë të jenë sigurisht se është më mirë, përfundoi ky diskutues.

Në vazhdim, pas votimit, u konstatua se njëzëri u miratua rekomandimi që Zyra për komunitete dhe kthim t'i ketë 7 zyrtarë.

4. Propozimi i Rregullores për përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Komunës së Podujevës

U përkrah njëzëri.

5. Propozimi i Rregullores për transparencën e punës të institucioneve të Komunës së Podujevës

U përkrah njëzëri.

6. Shqyrtimi i kërkesave të:

➤ Kemajl Halitit, nga fshati Orllan

z. Nebih Behluli, shprehu mendimin se kërkesa është plotësisht e arsyeshme dhe shtoi është ndjenjë e veçantë që një pjesëtar i komunitetit ashkalinj ka arritur të regjistrohet në shkollën e mesme amerikane por edhe të tregoj sukses mjaftë të mirë andaj propozimi im është që sipas mundësive financiare t'i ndihmohet maksimalisht sa është e mundur.

z. Jahë Lahu, theksoi se z. Kemajl Haliti, për ndihmë financiare me qëllim të krijimit të mundësive që i biri të përfundojë edhe vitin e katërt në shkollën e mesme Amerikane i është drejtuar shumë institucioneve në mes të të cilave është edhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe kryetari i Komunës së Podujevës, mirëpo deri më tash nuk ka gjetur kurrfarë zgjidhje. Përndryshe të përmendurit i është premtuar se pas përfundimit të shkollës së mesme në Kosovë, studimet e mëtejshme do t'i mundësohen në SHBA, përfundoi ky diskutues. Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Drejtorisë së Arsimit të shqyrtoi mundësitë që z. Kemajl Halitit, nga fshati Orllan, pjesëtar i komunitetit ashkalinj, për shpenzime të shkollimit sipas mundësive financiare t'i ndihmohet maksimalisht sa është e mundur.

➤ **Mursel Bajramit, nga Podujeva rr. "Ali Ajeti" p.n.**

Fjalën e hyrjes e paraqiti **kryesuesi z. Shaban Ahmeti**,

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të shqyrtoi mundësitë që z. Mursel Bajramit, nga Podujeva rr. 'Ali Ajeti' p.n, pjesëtar i komunitetit ashkalinj, për shpenzime të dërgimit në deti të të birit i cili lëngon nga këmba, sipas mundësive financiare t'i ndihmohet në rastin e cekur

Njëzëri u miratua rekomandimi që të shqyrtohen mundësit për ofrimin e ndihmës të përmendurit për dërgimin e të birit 12 vjeçar Fidimit për pushime në deti për shkak të lëngimit nga këmba.

7. Të ndryshme

z. Radisav Peroviq, njoftoi se gjendja e sigurisë në lagjen e sekiraqëve është e mirë dhe se nuk ka pasur asnjë aksent përveç vjedhjes së pyllit që është dukuri në rritje. Personalisht, vazhdoi ky diskutues, i kam hasur njerëzit duke prerë dru në pyllin ku sigurisht kishin prerë 10^3 mirëpo këtë rast nuk e kam lajmëruar në polici për arsye se me rastin e lajmërimit policia vjen menjëherë në vendin e ngjarjes mirëpo çështja mbetet me kaq nga se më pas nuk ndërmerret asgjë, këtë e them meqë deri më tash nuk është zbuluar asnjë rast i vjedhjeve apo prerjes ilegale të pyjeve.

Në vazhdim, në formë dialogu, u bisedua për shqyrtimin e mundësive për vizitë në ndonjë komunë të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01/217-06
Podujevë,
6 shtator 2010**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**